

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

“Ibraliu Electric” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 12.11.2024, une i poshtëshënuari;

Endri Ibraliu, i datëlindjes 12.11.1994, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ID J41112047B:

Me cilësinë e “ortakut themelues” deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Ibraliu Electric” shpk.**

Neni 1.

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **“Ibraliu Electric” shpk** dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

Shoqëria **“Ibraliu Electric” shpk** e ka seline në adresë: Njesia Bashkiake Nr 2, Rruga Naim Servet Frasher, banese private nr 6 Tirane dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimitarisë


Objekti i ushtrimit të veprimitarisë per shoqërine **“Ibraliu Electric” shpk** është; kryerja e veprimitarisë ne fushen elektrike, te instalimeve dhe te cdo procesi mirembajtje e riparime. Instalim rrjete kontrolli, kamera, network etj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Endri Ibraliu



Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë:

Endri Ibraliu, i datëlindjes 12.11.1994, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ID J41112047B zoteron 1(nje) kuote ose 100% te kalitalit te shoqerise. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë, pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be "Endri Ibraliu". Below the signature, there is a large, stylized, handwritten mark or initial, possibly "F", which is crossed out with a horizontal line. The entire signature and mark are positioned at the bottom right of the page.

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administratori

Administrator i shoqërisë **"Ibraliu Electric" shpk** është:

Endri Ibraliu, i datëlindjes 12.11.1994, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ID J41112047B. Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë që eshte data 12.11.2024. Afati i emërimit te administratorit eshte deri me 12.11.2029.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **"Ibraliu Electric" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKU THEMELUES

ENDRI IBRALIU

Tiranë, më datë 12.11.2024

